

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË**  
**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve**

**SKELETKURRIKULI**

**Për Drejtimin Mësimor**

**SHËRBIME SOCIALE DHE**  
**SHËNDETËSORE**

**Niveli I**

**Kodi: O-I-18**

Miratoi:

MINISTRI

**Tiranë, 2018**

## **Përmbajtja:**

- I. Qëllimet e arsimit profesional në drejtimin “Shërbime sociale dhe shëndetësore”, niveli I.**
- II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional “Shërbime sociale dhe shëndetësore”, niveli I.**
  1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional, në drejtimin “Shërbime sociale dhe shëndetësore”, niveli I.
  2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësit në përfundim të arsimimit në drejtimin “Shërbime sociale dhe shëndetësore”, niveli I.
  3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimimit në drejtimin “Shërbime sociale dhe shëndetësore”, niveli I.
  4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtjshëm në përfundim të arsimimit në drejtimin “Shërbime sociale dhe shëndetësore”, niveli I.
- III. Plani mësimor për drejtimin “Shërbime sociale dhe shëndetësore”, niveli I.**
- IV. Udhëzime për planin mësimor**
- V. Udhëzime për procesin mësimor.**
- VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.**
- VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimimit në drejtimin “Shërbime sociale dhe shëndetësore”, niveli I.**
- VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.**
- IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar.**
- X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar.**

## **I. Qëllimet e arsimit profesional në drejtimin “Shërbime sociale dhe shëndetësore”, niveli I.**

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në drejtimin “Shërbime sociale dhe shëndetësore”, niveli I, është *“zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me drejtimin “shërbime sociale dhe shëndetësore”.*

Për të realizuar këtë, shkolla profesionale u krijon nxënësve:

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehitë, qëndrimet dhe vlerat, të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt arsimit e formimit profesional të mëtejshëm;
- mbështetje për t’u njohur me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t’i zbatuar ato me rreptësi;
- mbështetje për t’u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës, që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, si dhe vlerat morale;
- mbështetje për t’u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht, për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës.

## **II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Shërbime sociale dhe shëndetësore”, niveli I**

### **1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional, në drejtimin “Shërbime sociale dhe shëndetësore”, niveli I.**

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në drejtimin mësimor “Shërbime sociale dhe shëndetësore” niveli I, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:

- kanë mbaruar arsimin e detyruar 9-vjeçar;
- janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.
- nëse kanë aftësi të kufizuara, shkolla krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë, MFE përgatit udhëzime të veçanta me kritere të posaçme pranimi për këto shkolla.

### **2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësit në përfundim arsimit në drejtimin “Shërbime sociale dhe shëndetësore”, niveli I.**

Në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Shërbime sociale dhe shëndetësore” niveli I, nxënësi do të zotërojë këto kompetenca të përgjithëshme kryesore:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.

- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efçente.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt, procesin e të nxënës të tij dhe të shfaqë gadishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

### **3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në drejtimin “Shërbime sociale dhe shëndetësore”, niveli I.**

Në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Shërbime sociale dhe shëndetësore” niveli I, nxënësi do të jetë i aftë të ushtrojë kompetencat profesionale si më poshtë:

- Të organizojë vendin e punës.
- Të zbatojë etikën profesionale të ndihmësit social.
- Të zbatojë ligjshmërinë përkatëse të shërbimit social-shëndetësor.
- Të zbatojë të drejtat e njeriut.
- Të zbatojë rregullat bazë të komunikimit.
- Të japë ndihmën e parë social-shëndetësore.
- Të kryejë përkujdesjen trupore për individët në nevojë social-shëndetësore.
- Të ndihmojë në të ushqyerit e individëve në nevojë social-shëndetësore.
- Të kryejë zhveshjen, larjen dhe veshjen e individëve në nevojë social-shëndetësore.
- Të kryejë pastrimin, dezinfektimin dhe sterilizimin e vetes, mjedisit, mjeteve, pajisjeve dhe materialeve.
- Të ndërtojë marrëdhënie profesionale me familjarët e individëve në nevojë social-shëndetësore.
- Të prezantojë veten me gojë dhe me shkrim.
- Të zhvillojë aftësinë e të punuarit në grup dhe të kapërcimit të ndryshimeve kulturore.
- Të zbatojë masat parandaluese për parandalimin e infeksioneve, kontrakturave, dekubitusit, pneumonive dhe trombozave.
- Të kryejë matjen e shenjave jetësore të organizmit të individët në nevojë social-shëndetësore.
- Të zbatojë recetën dhe rekomandimet e mjekut.
- Të ofrojë përkujdesjen sociale për grupe të ndryshme.
- Të prezantojë punën e ndihmësit social tek të interesuarit.
- Të shpjegojë efektet e lëndëve narkotike.
- Të reagojë në situata të sjelljeve devijante.
- Të kryejë vlerësimin e gjendjes dhe nevojave social-shëndetësore të individëve në nevojë dhe të atyre në prag të vdekjes.
- Të kryejë gjimnastikën shëruese për rivendosjen e funksioneve të aparatit të lëvizor dhe të sistemit vegjetativ tek individët në nevojë social-shëndetësore .

– Të identifikojë ndryshimet e njeriut gjatë fazave të ndryshme të zhvillimit.

#### 4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimimit në drejtimin “Shërbime sociale dhe shëndetësore”, niveli I.

Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “Shërbime sociale dhe shëndetësore”, niveli I, e pajis nxënësin me certifikatën e punonjësit gjysëm të kualifikuar (ndihmës) në këtë drejtim. Ky kualifikim i jep nxënësit mundësinë që t’i drejtohet tregut të punës për punësim në institucione të përkujdesit social-shëndetësor, qendra ditore ose rezidenciale të të moshuarve, të fëmijëve dhe të rinjve, shërbime në shtëpi si dhe në veprimtari të tjera që kanë lidhje me shërbimet sociale dhe shëndetësore.

Me përfundimin e arsimimit për “Shërbime sociale dhe shëndetësore”, niveli I, nxënësi ka të drejtë të vazhdojë arsimimin në nivelin II të kualifikimit profesional (njëvjeçar), në një nga profilet mësimore të këtij drejtimi. Me arsimim të mëtejshëm (në nivelin III) nxënësi fiton “Maturën shtetërore profesionale” me mundësi për vazhdimin e studimeve universitare dhe pas të mesmes.

### III. Plani mësimor për arsimin profesional në drejtimin “Shërbime sociale dhe shëndetësore”, niveli I

Plani mësimor për drejtimin “Shërbime sociale dhe shëndetësore” Niveli I				
Nr	Kodi	Lëndët dhe modulet mësimore	Orët javore/vjetore	
			Klasa 10	Klasa 11
<b>A.</b>		<b>Lëndët e përgjithshme</b> (Gjithsej)	<b>14/15</b> (504/ 540)	<b>11/12</b> (374/ 408)
1		Gjuhë shqipe	1	1
2		Letërsi	1	1
3		Gjuhë e huaj 1	2	2
4		Gjuhë e huaj 2 (me zgjedhje të lirë)	(1)	(1)
5		Matematikë	2	2
6		Fizikë	2	-
7		Kimi	-	2
8		Shkencat sociale	2	-
9		Histori	-	2
10		Gjeografi	1	-
11		Teknologji informimi e komunikimi	1	-
12		Edukim fizik, sporte, shëndet	2	1
<b>B.</b>		<b>Lëndët profesionale</b> (Gjithsej)	<b>10</b> (360)	<b>8</b> (272)
1	L-20-468-18	Etika profesionale dhe legjislacioni	3	-
2	L-20-087-18	Psikopedagogjia	3	-
3	L-21-469-18	Bazat e anatomisë së njeriut	2	-
4	L-21-089-18	Edukimi shëndetësor dhe higjiena	2	2
5	L-20-090-18	Bazat e ndërhyrjes sociale	-	2

6	L-21-091-18	Barnat mjekësore dhe alternative	-	2
7	L-21-470-18	Bazat e fiziologjisë së njeriut		2
<b>C.</b>		<b>Module të detyruar të praktikës profesionale (Gjithsej)</b>	<b>5 (180)</b>	<b>10 (340)</b>
1	M-21-244-11	Dhënia e ndihmës së parë	36	-
2	M-21-245-11	Kryerja e përkujdesjes trupore te individët në nevojë	36	-
3	M-21-767-11	Të ushyerit, zhveshja, larja dhe veshja e individëve në nevojë	36	-
4	M-21-248-11	Pastrimi, dezinfektimi, sterilizimi	36	-
5	M-20-249-11	Ndërtimi i marrëdhënieve profesionale me familjarët	36	-
6	M-20-250-11	Bashkëveprimi ndërkulturor	-	51
7	M-21-251-11	Zbatimi i masave parandaluese shëndetësore	-	69
8	M-21-252-18	Matja e shenjave jetësore të organizmit	-	69
9	M-21-253-11	Zbatimi praktik i recetës dhe i rekomandimeve të mjekut	-	51
10	M-20-254-18	Kryerja e përkujdesjes për grupime të ndryshme të individëve në nevojë	-	66
11	M-20-255-11	Respektimi i etikës profesionale dhe i të drejtave të njeriut	-	34
<b>D.</b>		<b>Modulet e praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar (Gjithsej)</b>	<b>1 (36)</b>	<b>2 (68)</b>
1	M-20-256-09	Qëndrimi ndaj sjelljeve devijante dhe lëndëve narkotike	36	-
2	M-21-257-09	Vlerësimi i gjendjes social-shëndetësore të individëve në nevojë	36	-
3	M-21-258-09	Kryerja e gjimnastikës shëruese	-	68
4	M-20-259-09	Identifikimi i zhvillimeve kryesore të njeriut në grupmosha të ndryshme	-	68
		<b>Gjithsej A+B+C+D</b>	<b>30/31 (1080/1116)</b>	<b>31/32 (1054/1088)</b>

#### IV. Udhëzime për planin mësimor

Kohëzgjatja e vitit shkollor është:

Në klasën 10, viti shkollor ka gjithsej 36 javë (36 javë mësimore)

Në klasën 11 viti shkollor ka gjithsej 36 javë (34 javë mësimore + 1 javë provimi i praktikës profesionale + 1 javë për provimin e teorisë profesionale).

Një javë mësimore ka jo më shumë 32 orë mësimore (teorike dhe praktike).

Një orë mësimore zgjat 45 minuta.

Kurrikuli i arsimit profesional në drejtimin “Shërbime sociale dhe shëndetësore”, niveli I, përbëhet nga 4 grupe elementesh kurrikulare:

- Lëndët e kulturës së përgjithshme, të përbashkëta për drejtimet e ndryshme të këtij niveli (programet e detajuara të tyre jepen në një dokument të veçantë të MASR).
- Lëndët e kulturës profesionale (programet e përgjithëshme janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale të detyruara (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).

- Modulet e praktikave profesionale me zgjedhje të detyruar (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).

Rekomandohet që modulet e praktikës profesionale të realizohen në ndarje ditore 3 orëshe ose 6 orëshe.

## V. Udhëzime për procesin mësimor.

Mësuesit e lëndëve teorike profesionale dhe instruktorët e moduleve të praktikave profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin tek ta, të kompetencave të punës, të plota dhe të qëndrueshme.

E rëndësishme është që *planifikimi i mësimdhënies* të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e lëndëve profesionale dhe e moduleve të praktikave profesionale të parashikuara dhe shkalla e integritit të tyre, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës.

Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është *motivimi i nxënësve*. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përmbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.

Një element tjetër që ndihmon suksesin është *integrimi i teorisë me praktikën* e profesionit. Parimi i “të nxënit duke bërë” duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat profesionale të drejtimit “Shërbime sociale dhe shëndetësore”, niveli I.

Mësuesit dhe instruktorët duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathtësitë dhe shprehitë praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup* dhe *Puna me projekte* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimit (teorik ose praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi.

Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit dhe instruktorët është fakti që *të nxënit nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm të drejtimit profesional “Shërbime sociale dhe shëndetësore”.

Në rastin e nxënësve me aftësi të kufizuara, mësuesit duhet të përshtasin programet e lëndëve dhe përshkruesit e moduleve në përputhje me mundësitë e tyre, si dhe të krijojnë kushte për zbatimin e tyre.

## VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.

Vlerësimi vjetor i nxënësve në lëndët teorike profesionale dhe modulet e praktikave profesionale bëhet nga vetë mësuesit dhe instruktorët përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me **nota** (4-10) si për lëndët teorike, ashtu edhe për modulet praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.

Në përfundim të klasës së njëmbëdhjetë, nxënësi i arsimuar në drejtimin profesional “Shërbime sociale dhe shëndetësore”, niveli I, i nënshtrohet provimeve të mëposhtme:

- a) Provimi i teorisë profesionale të integruar;
- b) Provimi i praktikës profesionale të integruar;

Në këto provime ata vlerësohen për shkallën e përvetësimit të kompetencave profesionale

(njohurive, shprehive, vlerave dhe qëndrimeve), të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën e shërbimit të automjeteve, dhe u jepet certifikata, në të cilën evidentohen notat përfundimtare të lëndëve teorike profesionale, të moduleve të praktikës profesionale, të lëndëve të përgjithshme, për çdo vit shkollor, si dhe rezultatet e dy provimeve përfundimtare të nivelit I.

## **VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Shërbime sociale dhe shëndetësore”, niveli I**

Me përfundimin e suksesshëm të arsimit profesional në drejtimin mësimor “Shërbime sociale dhe shëndetësore”, niveli I, shkolla profesionale e pajis nxënësin me Dëftesën e përfundimit të këtij niveli si dhe me Certifikatën e aftësisimit profesional, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas modelit të miratuar nga MFE, këto dëshmi përmbajnë:

- a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar, etj.
- b) Të dhëna për rezultatet e arritura nga nxënësi:
  - rezultatet në lëndët e përgjithshme, lëndët profesionale dhe modulet profesionale, për çdo vit shkollor;
  - rezultatet e dy provimeve përfundimtare të Nivelit I.



## VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

### 1. Lënda “Etika profesionale dhe legjislacioni” (L-20-468-18). Kl. 10 – 108 orë

- Synimet e lëndës “Etika profesionale dhe legjislacioni”, kl. 10.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Etika profesionale dhe legjislacioni”, kl.10, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë kodin profesional dhe etik të personave përkujdesës.
- Të përshkruajnë rolet dhe përgjegjësitë e personave përkujdesës.
- Të shpjegojnë rëndësinë e etikës profesionale në shërbimet sociale.
- Të shpjegojnë rëndësinë e respektit për individët në nevojë pavarësisht moshës, gjinisë, besimit fetar dhe përkatësisë racore.
- Të përshkruajnë të drejtën e individit për shërbime dhe mbështetje.
- Të shpjegojnë të drejtën e privatësisë së individit dhe familjarëve të tij.
- Të përshkruajnë diversitetin e qenies njerëzore dhe rëndësinë e respektimit të tij.
- Të shpjegojnë konceptin ”shprehi e të dëgjuarit”.
- Të shpjegojnë çdo të thotë të qenit i sinqertë, i hapur dhe i drejtpërdrejtë në komunikim.
- Të shpjegojnë si bëhet referimi i klientit tek shërbimet e kërkuara.
- Të tregojnë si veprohet në rast pamundësie të ofrimit të shërbimit të kërkuar.
- Të përshkruajnë mënyrën e sjelljes së ndihmësit social në familjet me probleme.
- Të përshkruajnë mënyrën e sjelljes dhe qëndrimit të ndihmësit social me familjarët e individit, të cilit i ofrohet shërbimi.
- Të listojnë standardet e shërbimeve sociale.
- Të përshkruajnë konceptet bazë të legjislacionit të shërbimeve sociale.
- Të listojnë llojet e komunikimit.
- Të përshkruajnë metodat dhe modelet e komunikimit.
- Të listojnë pengesat në procesin e komunikimit.
- Të përshkruajnë komunikimin në familje.
- Të shpjegojnë rregullat e komunikimit me grupet në nevojë.
- Të përshkruajnë komunikimin ndërkulturor.
- Të përshkruajnë rëndësinë e teknologjisë në komunikim.

- Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Etika profesionale dhe legjislacioni”, kl.10 - 108 orë

<b>Tema 1</b>	Njohuri të përgjithshme mbi etikën dhe deontologjinë në shërbimet sociale	5 orë
<b>Tema 2</b>	Kodi profesional dhe etik i personave përkujdesës	5 orë
<b>Tema 3</b>	Rolet dhe përgjegjësitë e personave përkujdesës	8 orë
<b>Tema 4</b>	Respekti ndaj klientit	5 orë
<b>Tema 5</b>	Privatësia dhe mbrojtja e saj	4 orë
<b>Tema 6</b>	Diversiteti i qenies njerëzore	5 orë
<b>Tema 7</b>	Karakteristikat e një punonjësi mbështetës: Shprehitë e të dëgjuarit	5 orë
<b>Tema 8</b>	Të qenit i sinqertë, i hapur dhe i drejtpërdrejtë	5 orë
<b>Tema 9</b>	Nevoja e referimit	4 orë

<b>Tema 10</b>	Rastet e pamundësisë së trajtimit të klientëve	7 orë
<b>Tema 11</b>	Etika e shërbimit në familje me probleme	5 orë
<b>Tema 12</b>	Njohuri bazë për standartet dhe legjislacionin e shërbimeve sociale	6 orë
<b>Tema 13</b>	Llojet e komunikimit	5 orë
<b>Tema 14</b>	Metodat dhe modelet e komunikimit	10 orë
<b>Tema 15</b>	Pengesat në procesin e komunikimit	6 orë
<b>Tema 16</b>	Komunikimi në familje	5 orë
<b>Tema 17</b>	Komunikimi me grupet në nevojë	10 orë
<b>Tema 18</b>	Komunikimi ndërkulturor	4 orë
<b>Tema 19</b>	Komunikimi dhe teknologjia	4 orë

## 2. Lënda “Psikopedagogjia” (L-20-087-18). Kl. 10-108 orë

### • Synimet e lëndës “Psikopedagogjia”, kl. 10

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Psikopedagogjia”, klasa 10, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë rëndësinë e studimit psikopedagogjik të njeriut.
- Të përshkruajnë bazat e zhvillimit biologjik të individit që nga konceptimi deri në lindje.
- Të përshkruajnë zhvillimin fiziko-motor të të porsalindurve dhe foshnjave.
- Të përshkruajnë çrregullimet biologjike që mund të shfaqen në çdo fazë zhvillimi të individit.
- Të përshkruajnë ndryshimet fizike që ndodhin në organizmin e njeriut gjatë fazave të ndryshme të jetës.
- Të përshkruajnë zhvillimin fiziko-motor të të porsalindurve dhe foshnjave.
- Të tregojnë aspektet e zhvillimit fizik në fëmijëri.
- Të përshkruajnë zhvillimin fizik të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe atyre me nevoja të veçanta.
- Të listojnë karakteristikat e zhvillimit fizik gjatë pubertetit.
- Të përshkruajnë zhvillimin biologjik në të gjitha fazat e adoleshencës.
- Të përshkruajnë zhvillimet sociale dhe problemet që shfaqen në adoleshencë.
- Të përshkruajnë karakteristikat e marrëdhënieve njerëzore në moshën e rinisë dhe moshën e mesme.
- Të tregojnë bazat e një komunikimi të përshtatshëm për punën dhe stilin e jetës në moshën e rinisë dhe në moshën e mesme.
- Të përshkruajnë zhvillimet karakteristike të moshës së mesme.
- Të përshkruajnë funksionet biologjike të individëve të moshës së tretë.
- Të përshkruajnë shërbimet e nevojshme për individët e moshës së tretë.
- Të përshkruajnë disa nga sëmundjet e moshës së tretë dhe ti shpjegoje ato.
- Të përshkruajnë mbështetjen që ofrohet për individët me sëmundje të rënda dhe për ata që janë në prag të vdekjes.
- Të përdorin mjedisin për të siguruar shërbimin e nevojshëm sipas nevojave.

• Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Psikopedagogjia”, kl. 10 -108 orë

<b>Tema 1</b>	Hyrje. Rëndësia e studimit psikopedagogjik të njeriut	4 orë
	<b>Pjesa e parë. Zhvillimi prenatal, foshnjëria dhe fëmijëria.</b>	
<b>Tema 2</b>	Bazat biologjike nga konceptimi deri tek lindja	10 orë
<b>Tema 3</b>	Zhvillimi fiziko –motor i të porsalindurve dhe foshnjeve	9 orë
<b>Tema 4</b>	Zhvillimi i të menduarit dhe gjuhës	4 orë
<b>Tema 5</b>	Ndryshimet e njeriut gjatë fazave të ndryshme të zhvillimit	6 orë
	<b>Pjesa e dytë. Fëmijëria dhe adoleshenca</b>	
<b>Tema 6</b>	Zhvillimi fiziko -motor të të porsalindurit dhe foshnjat	6 orë
<b>Tema 7</b>	Aspektet e zhvillimit fizik të individit në fëmijëri;	4 orë
<b>Tema 8</b>	Zhvillimi fizik i fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe atyre me nevoja të veçanta;	8 orë
<b>Tema 9</b>	Zhvillimi fizik gjatë pubertetit	4 orë
<b>Tema 10</b>	Zhvillimi biologjik në të gjitha fazat e adoleshencës	6 orë
<b>Tema 11</b>	Zhvillimet sociale dhe problematika e moshës së adoleshencës	4 orë
	<b>Pjesa e tretë. Moshë e rinisë dhe moshë e mesme.</b>	
<b>Tema 12</b>	Marrëdhëniet njerëzore në moshën e rinisë dhe atë të mesme	4 orë
<b>Tema 13</b>	Puna dhe stili i jetesës në moshën e rinisë dhe në moshën e mesme	4 orë
<b>Tema 14</b>	Zhvillimet karakteristike të moshës së mesme	6 orë
	<b>Pjesa e katërt. Moshë e tretë, pleqëria</b>	
<b>Tema 15</b>	Marrëdhëniet njerëzore në moshën e tretë	6 orë
<b>Tema 16</b>	Njohuri mbi funksionet biologjike të individëve të moshës së tretë	7 orë
<b>Tema 17</b>	Shërbimet e nevojshme për individët e moshës së tretë	6 orë
<b>Tema 18</b>	Sëmundjet tipike të moshës së tretë	8 orë
<b>Tema 19</b>	Përballja me vdekjen	2 orë

**3. Lënda “Bazat e anatomisë së njeriut” (L-21-469-18). Kl. 10 – 72 orë**

• Synimet e lëndës “Bazat e anatomisë së njeriut”, kl. 10

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e anatomisë së njeriut”, kl.10, nxënësit duhet:

- Të përkufizojnë objektin e studimit të anatomisë.
- Të përshkruajnë sistemin kockor.
- Të listojnë elementët e artikulacioneve.
- Të tregojnë përbërjen e muskujve.
- Të listojnë organet që përbëjnë sistemin tretës.
- Të rendisin organet që përbëjnë sistemin respirator.
- Të përshkruajnë ndërtimin e sistemit urinar.
- Të shpjegojnë ndërtimin e sistemit kardio-vaskular.
- Të identifikojnë përbërjen e sistemit nervor.
- Të listojnë gjëndrat e sistemit endokrin.
- Të tregojnë përbërjen e sistemit genital.
- Të tregojnë përbërjen e sistemit të shqisave.
- Të përshkruajnë përbërjen e lëkurës.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e anatomisë së njeriut”, kl. 10 - 72 orë**

Tema 1	Hyrje në anatominë e njeriut	4 orë
Tema 2	Sistemi kockor	6 orë
Tema 3	Sistemi artikular	6 orë
Tema 4	Sistemi muskular	8 orë
Tema 5	Sistemi tretës (digjektiv)	7 orë
Tema 6	Sistemi respirator	6 orë
Tema 7	Sistemi urinar	4 orë
Tema 8	Sistemi genital	5 orë
Tema 9	Sistemi kardio-vaskular	8 orë
Tema 10	Sistemi nervor	8 orë
Tema 11	Sistemi endokrin	4 orë
Tema 12	Organet e shqisave	4 orë
Tema 13	Lëkura dhe strukturat e lidhura me të	2 orë

#### **4. Lënda “Edukimi shëndetësor dhe higjiena” (L-21-089-18). Kl. 10 -72 orë dhe Kl. 11 - 68 orë**

- **Synimet e lëndës “Edukimi shëndetësor dhe higjiena”, kl. 10**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Edukimi shëndetësor dhe higjiena”, klasa 10, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë shëndetin dhe modelet e tij.
- Të përshkruajnë sëmundjet dhe stadet e saj.
- Te përshkruajnë historikun e përkujdesjes social-shëndetësore.
- Të përshkruajnë qëllimet e përkujdesjes social-shëndetësore.
- Të shpjegojnë organizimin e përkujdesjes social-shëndetësore.
- Të shpjegojnë shenjat jetësore.
- Të shpjegojnë nevojat fiziologjike.
- Të përshkruajnë rëndësinë e aktiviteteve fizike në përkujdesjen social-shëndetësore.
- Të përshkruajnë mjetet ndihmëse dhe përdorimin e tyre.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Edukimi shëndetësor dhe higjiena”, kl. 10-72 orë**

Tema 1	Shëndeti dhe modelet e tij	8 orë
Tema 2	Sëmundja dhe stadet e saj	8 orë
Tema 3	Historiku i përkujdesjes social-shëndetësore	6 orë
Tema 4	Qëllimet e përkujdesjes social-shëndetësore	8 orë
Tema 5	Organizimi i përkujdesjes social-shëndetësore	8 orë
Tema 6	Shenjat jetësore të organizmit	10 orë
Tema 7	Nevojat fiziologjike	10 orë
Tema 8	Rëndësia e aktiviteteve fizike në përkujdesjen social- shëndetësore	8 orë
Tema 9	Përdorimi i mjeteve ndihmëse	6 orë

- **Synimet e lëndës “Edukimi shëndetësor dhe higjiena”, kl. 11 – 68 orë**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Edukimi shëndetësor dhe higjiena”, kl. 11, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë konceptin higjienë dhe rëndësinë e saj.
- Të interpretojnë detyrat e grupeve profesionale të higjienës.
- Të përmbushin porositë dhe udhëzimet mjekësore.
- Të listojnë standartet e higjienës.
- Të shpjegojnë bazat funksionale ndërtimore të higjienës.
- Të identifikojnë sëmundjet infektive dhe rrugët e trasmetimit të infeksionit.
- Të përshkruajnë si bëhet kontrolli i sëmundjeve infektive.
- Të tregojnë si bëhet pastrimi dhe dezinfektimi i sipërfaqeve dhe ambienteve.
- Të listojnë rrugët e përhapjes së infeksioneve.
- Të sqarojnë metodat fizike të dezinfektimit edhe sterilizimit.
- Të përshkruajnë pastrimin e sipërfaqeve dhe ambienteve.
- Të përshkruajnë mikrobiologjinë mjekësore.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Edukimi shëndetësor dhe higjiena”, kl. 11-68 orë**

<b>Tema 1</b>	Hyrje. Njohuri të përgjithshme mbi higjienën	4 orë
<b>Tema 2</b>	Grupet profesionale në higjienë	6 orë
<b>Tema 3</b>	Porositë dhe udhëzimet mjekësore.	6 orë
<b>Tema 4</b>	Standartet e higjienës	6 orë
<b>Tema 5</b>	Bazat funksionale ndërtimore të higjienës	8 orë
<b>Tema 6</b>	Sëmundjet infektive dhe rrugët e trasmetimit të infeksionit	12 orë
<b>Tema 7</b>	Pastrimi dhe dezinfektimi i sipërfaqeve dhe ambjenteve	6 orë
<b>Tema 8</b>	Metodat fizike të dezinfektimit dhe sterilizimit	8 orë
<b>Tema 9</b>	Pastrimi i sipërfaqes dhe ambienteve	6 orë
<b>Tema 10</b>	Bazat e mikrobiologjisë mjekësore	6 orë

## 5. Lënda “Bazat e ndërhyrjes sociale” (L-20-090-18). Kl. 11 – 68 orë

- **Synimet e lëndës “Bazat e ndërhyrjes sociale”, kl. 11 – 68 orë**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e ndërhyrjes sociale”, kl. 11, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë ç`është ndërhyrja sociale.
- Të karakterizojnë nga pikëpamja sociale mjedisin ku jetojnë dhe punojnë.
- Të shpjegojnë ç`është mirëqënia sociale.
- Të dallojnë personat dhe grupet në nevojë.
- Të përkufizojnë autoritarizmin social.
- Të shpjegojnë si bëhet ndërhyrja sociale në komunitet, familje dhe individë.
- Të tregojnë si vendosen marrëdhëniet me individin dhe grupin.
- Të përkufizojnë socializimin e njeriut.
- Të përshkruajnë disa mënyra organizimi me qëllim realizimin e aktiviteteve edukative dhe argëtuese.
- Të identifikojnë një sjellje devijante.
- Të dallojnë sjelljet paragjyqëse.

- Të dallojnë rastet e diskriminimit.
- Të listojnë llojet e diskriminimit.
- Të listojnë efektet e drogës, duhanit, alkolit.
- Të listojnë sëmundjet seksualisht të transmetueshme.
- Të përshkruajnë zhvillimin psikologjik në moshat e hershme.
- Të përshkruajnë zhvillimin psikologjik në moshat e rritura.
- Të dallojnë situatat konfliktuale dhe burimin e tyre.
- Të tregojnë si realizohet vlerësimi dhe vetëvlerësimi.
- Të shpjegojnë rëndësinë e motivimit dhe vetëmotivimit.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e ndërhyrjes sociale”, kl 11 - 68 orë**

<b>Tema 1</b>	Hyrje. Ndërhyrja sociale dhe mjedisi social	4 orë
<b>Tema 2</b>	Mirëqenia sociale	3 orë
<b>Tema 3</b>	Grupet në nevojë dhe zbutja e problemeve sociale	5 orë
<b>Tema 4</b>	Autoritarizmi social	4 orë
<b>Tema 5</b>	Ndërhyrja sociale në komunitet, familje dhe individë	6 orë
<b>Tema 6</b>	Marrëdhëniet me individin dhe ato në grup	3 orë
<b>Tema 7</b>	Socializimi i njeriut	3 orë
<b>Tema 8</b>	Shërbime edukative dhe argëtuese	3 orë
<b>Tema 9</b>	Marrëdhënia ndërpersonale	3 orë
<b>Tema 10</b>	Sjellja devijante	5 orë
<b>Tema 11</b>	Diskrimimi dhe llojet e tij	5 orë
<b>Tema 12</b>	Duhani, alkoli, droga	3 orë
<b>Tema 13</b>	Sëmundjet seksualisht të transmetueshme	3 orë
<b>Tema 14</b>	Zhvillimi psikologjik në moshat e hershme	3 orë
<b>Tema 15</b>	Zhvillimi psikologjik në moshat e rritura	4 orë
<b>Tema 16</b>	Konfliktet. Burimi dhe adresimi i tyre	5 orë
<b>Tema 17</b>	Vlerësimi dhe vetëvlerësimi	3 orë
<b>Tema 18</b>	Motivimi dhe vetëmotivimi	3 orë

**6. Lënda “Barnat mjekësore dhe alternative” (L-21-091-18). Kl. 11 – 68 orë**

• **Synimet e lëndës “Barnat mjekësore dhe alternative”, kl. 11**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Barnat mjekësore dhe alternative”, kl.11, nxënësit duhet:

- Të kenë njohuri të përgjithshme mbi barnat.
- Të tregojnë format farmaceutike të barnave.
- Të për zgjedhin dozimin e duhur të barnave.
- Të listojnë rregullat e kujdesit në përdorimin e barnave.
- Të listojnë rrugët e marrjes së barnave.
- Të përshkruajnë mënyrën e shpërndarjes së barnave në organizëm.
- Të shpjegojnë metabolizmin e barnave në organizëm.
- Të tregojnë rrugët e eliminimit të barnave.
- Të listojnë faktorët që ndikojnë mbi efektin e barit.
- Të listojnë barnat me efekt në qarkullimin e gjakut dhe zemër.

- Të listojnë barnat me efekt në traktin e frymëmarrjes.
- Të listojnë barnat me efekt në sistemin nervor.
- Të listojnë barnat me efekt në sistemin e tretjes.
- Të listojnë barnat me efekt tek syri dhe veshi.
- Të përshkruajnë kimioterapinë.
- Të përshkruajnë alergjinë medikamentoze dhe efektet e padëshiruara.
- Të përshkruajnë bimët mjekësore dhe barnat popullore.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Barnat mjekësore dhe alternative”, kl. 11-68 orë**

Tema 1	Njohuri mbi barnat	2 orë
Tema 2	Format farmaceutike të barnave	3 orë
Tema 3	Dozimi i barnave	4 orë
Tema 4	Kujdesi në përdorimin e barnave	2 orë
Tema 5	Rrugët e marrjes së barnave	4 orë
Tema 6	Shpërndarja dhe metabolizimi i barnave në organizëm	4 orë
Tema 8	Eliminimi i barnave	3 orë
Tema 9	Faktorët që ndikojnë në efektin e barit	2 orë
Tema 10	Barnat me efekt në qarkullimin e gjakut dhe zemër	6 orë
Tema 11	Barnat me efekt në traktin e frymëmarrjes	6 orë
Tema 12	Barnat me efekt në sistemin nervor	6 orë
Tema 13	Barnat me efekt në sistemin e tretjes	6 orë
Tema 14	Barnat me efekt tek syri dhe veshi	5 orë
Tema 15	Kimioterapia	5 orë
Tema 16	Alergjia medikamentoze dhe efektet e padëshiruara të barnave	5 orë
Tema 17	Bimët mjekësore dhe barnat popullore	5 orë

**7. Lënda “Bazat e fiziologjisë së njeriut ” (L-21-470-18). Kl. 11 - 68 orë**

• **Synimet e lëndës “Bazat e fiziologjisë së njeriut”, kl. 11 - 68 orë**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e fiziologjisë së njeriut”, kl.11, nxënësit duhet:

- Të përkufizojnë objektin e studimit të fiziologjisë.
- Të shpjegojnë funksionin e qelizës.
- Të percaktojnë transportin membranor.
- Të përshkruajnë funksionin e sistemit nervor.
- Të përshkruajnë funksionin e sistemit të pamjes.
- Të shpjegojnë funksionin e organit të dëgjimit dhe ekujlibrit
- Të përshkruajnë funksionin e muskujve.
- Të shpjegojnë funksionin e gjakut dhe të sistemit imunitar.
- Të përshkruajnë funksionin e sistemit kardio-vaskular.
- Të shpjegojnë funksionin e sistemit respirator.
- Të përshkruajnë funksionin e sistemit tretës.
- Të tregojnë funksionin e sistemit endokrin
- Të shpjegojnë funksionin e sistemit renal.

- Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e fiziologjisë së njeriut”, kl. 11 - 68 orë

Tema 1	Hyrje në fiziologji	3 orë
Tema 2	Qeliza dhe funksionet saj	5 orë
Tema 3	Transporti membranor	5 orë
Tema 4	Funksioni i sistemit nervor	6 orë
Tema 5	Sistemi i pamjes	4 orë
Tema 6	Funksioni i organit të dëgjimit dhe ekujlibrit	4 orë
Tema 7	Funksioni i muskujve	6 orë
Tema 8	Imuno-hematologjia	5 orë
Tema 9	Zemra dhe qarkullimi i gjakut	7 orë
Tema 10	Funksioni i sistemit respirator	6 orë
Tema 11	Funksioni i sistemit tretës	7 orë
Tema 12	Funksioni i sistemit endokrin	5 orë
Tema 13	Veshka dhe kontrolli i lëngjeve të trupit, elektrolitëve e balancës acido-bazike	5 orë



## IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar

### 1. Moduli “Dhënia e ndihmës së parë”

Drejtimi: Shërbime sociale dhe shëndetësore

Niveli: I

Klasa: 10

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	DHËNIA E NDIHMËS SË PARË	M-21-244-11
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që e pajis nxënësin me aftësi për të dhënë ndihmën e parë në raste fatkeqësish, sëmundjesh akute, aksidentesh dhe të tjera rreziqe për jetën sipas protokolleve dhe metodave të njohura, si dhe për të evidentuar dhe dokumentuar të dhëna të thjeshta menjëherë në vendngjarje dhe gjatë transportit deri në qendrën mjekësore me të afërt.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<b>RM 1 Nxënësi vlerëson urgjencën sipas rastit që paraqitet</b> <b>Përmbajtja:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Sipërmarrja e të dëmtuarit</li><li>- Përcaktimi i prioriteteve të veprimit.</li><li>- Pozicionimi i të dëmtuarit në pozicionin e përshtatshëm</li><li>- Vlerësimi i gjendjes së komunikimit të të dëmtuarit.</li><li>- Vlerësimi i frymëmarjes së të dëmtuarit.</li><li>- Gjetja e pulsit në qafën e të dëmtuarit.</li><li>- Kontrolli i ritmit dhe fortësisë së pulsit tek i dëmtuari.</li><li>- Vlerësimi i gjakosjes/hemoragjisë së të dëmtuarit.</li><li>- Kontrolli dhe lirimi i rrugëve të frymëmarjes</li><li>- Vlerësimi i madhësisë dhe gravitetit të plagëve.</li><li>- Vlerësimi i dëmtimeve kockore.</li><li>- Vlerësimi i dhimbjeve të forta</li><li>- Vlerësimi i ndjenjës së të vjellave</li><li>- Vlerësimi i vështirësisë në frymëmarrje</li><li>- Vlerësimi i rritjes së temperaturës trupore</li><li>- Sigurimi i transportimit të të dëmtuarit</li></ul> <b>Instrumentet e vlerësimit:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Vëzhgim me listë kontrolli.</li></ul> <b>Kriteret e vlerësimit:</b> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- të marrë përsipër të dëmtuarin me të gjitha nevojat që ai paraqet.</li><li>- të përcaktojë shpejt dhe saktë prioritet e veprimit</li></ul>	

- të pozicionojë të dëmtuarit në pozicionin e përshtatshëm
- të vlerësojë gjendjen e komunikimit të të dëmtuarit.
- të vlerësojë frymëmarjen e të dëmtuarit.
- të gjejë pulsën në qafën e të dëmtuarit.
- të kontrollojë ritmin dhe fortësinë e pulsit tek i dëmtuari.
- të vlerësojë gjakosjen/hemoragjinë e të dëmtuarit.
- të kontrollojë dhe lirojë rrugët e frymëmarjes
- të vlerësojë madhësinë dhe gravitetin e plagëve.
- të vlerësojë dëmtimet kockore.
- të vlerësojë dhimbjet e forta
- të vlerësojë ndjenjën e të vjellave,
- të vlerësojë vështirësinë në frymë-marrje
- të vlerësojë rritjen e temperaturës trupore
- të sigurojë transportimin sa më të shpejte dhe komod të të dëmtuarit
- të raportojë saktë gjendjen e të sëmurit tek ekipi i ambulancës ose urgjencës

## **RM 2 Nxënësi jep ndihmën e parë në vendngjarje**

### ***Përmbajtja:***

- Ndhimja e parë në rast hemoragjie dhe plage
- Ndhimja e parë në rast gjendje shoku
- Ndhimja e parë në rast djegieje
- Ndhimja e parë në rast thyerje të kockave
- Ndhimja e parë në rast helmimi
- Ndhimja e parë në rast të fikëti
- Ndhimja e parë në rast ngrirjeje
- Ndhimja e parë në rast goditje nga dielli
- Ndhimja e parë në rast humbje të lëngjeve (dehidrimi)
- Ndhimja e parë në rast pickime nga insektet
- Ndhimja e parë në rast atak zemre
- Ndhimja e parë në rast overdoze
- Ndhimja e parë në rast goditje nga rryma elektrike

### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të japë ndihmën e parë në rast hemoragjie dhe plage
- të japë ndihmën e parë në rast gjendje shoku
- të japë ndihmën e parë në rast djegieje
- të japë ndihmën e parë në rast thyerje të kockave
- të japë ndihmën e parë në rast helmimi
- të japë ndihmën e parë në rast të fikëti
- të japë ndihmën e parë në rast ngrirjeje
- të japë ndihmën e parë në rast goditje nga dielli
- të japë ndihmën e parë në rast humbje të lëngjeve (dehidrimi)
- të japë ndihmën e parë në rast pickimi nga insektet
- të japë ndihmën e parë në rast atak zemre
- të japë ndihmën e parë në rast overdoze

- të japë ndihmën e parë në rast goditje nga rryma elektrike

### **RM 3 Nxënësi dokumenton të dhëna të thjeshta**

#### ***Përmbajtja:***

- Shënimi i emër/mbiemër të të dëmtuarit
- Shkrimi i kohës së saktë të dëmtimit
- Shkrimi i të gjitha dëmtimeve të vlerësuara tek i dëmtuari
- Përshkrimi i të gjithë ndihmës së dhënë deri në atë moment
- Përshkrimi i vrojtimeve të veçanta dhe të rëndësishme për jetën e të dëmtuarit

#### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

#### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të shënojë emrin-mbiemrin e të dëmtuarit
- të shkruajë kohën e saktë dëmtimit
- të shkruajë të gjitha dëmtimet e vlerësuara tek i dëmtuari
- të përshkruajë të gjithë ndihmën e dhënë deri në atë moment
- të përshkruajë vrojtimit e veçanta dhe të rëndësishme për jetën e të dëmtuarit

---

#### **Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në kabinetet e ndihmës së parë.
- Mësuesi duhet të ilustroje dhe instruktojë në mënyrë sa më korekte të gjitha etapat e ndihmës së parë .
- Nxënësit duhet të angazhohen sa më shumë në veprimtari konkrete, në mbështetje të përvetësimit të shprehive që trajton moduli.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të shprehive të fituara.

---

#### **Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Mjedis i bollshëm për kryerjen e të gjitha veprimeve të ndihmës së parë:
  - Pajisje si kukulla mësimore, mjete ndihmëse rrethore për dhënie të ndihmës së parë;
  - Mteriale të ndihmës së parë të fabrikuara/ kutitë e ndihmës së parë në makina;
  - Udhëzues, rregullore, etj.
-

## 2. Moduli “Kryerja e përkujdesjes trupore te individët në nevojë”

Drejtimi: Shërbime sociale dhe shëndetësore

Niveli: I

Klasa: 10

### PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	KRYERJA E PËRKUJDESJES TRUPORE TE INDIVIDËT NË NEVOJË	M-21-245-11
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për të realizuar përkujdesjen trupore në përshtatje me nevojat specifike të individit.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p><b>RM 1 Nxënësi përcakton gjendjen e përgjithshme të individit në nevojë.</b></p> <p><b>Përmbajtja</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Përcaktimi i gjendjes fizike të individit në nevojë.</li><li>- Evidentimi i ndikimeve të klimës dhe të motit.</li><li>- Përcaktimi i gjendjes mendore dhe shpirtërore të individit në nevojë.</li><li>- Kontrolli i mjediseve sanitare të individit në nevojë.</li><li>- Zbulimi i ritualeve zakonore të individit në nevojë.</li><li>- Zbulimi i traditës familjare në kontekstin e përkujdesjes trupore.</li><li>- Evidentimi i gjendjes financiare të individit në nevojë.</li><li>- Informimi i individit për rëndësinë e përkujdesjes trupore.</li><li>- Respektimi i përkatësisë gjinore, moshës dhe statusit social të individit në nevojë.</li></ul> <p><b>Instrumentet e vlerësimit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Vëzhgim me listë kontrolli</li></ul> <p><b>Kriteret e vlerësimit:</b></p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- të përcaktojë gjendjen fizike të individit në nevojë;</li><li>- të evidentojë ndikimet e klimës dhe të motit për individin në nevojë;</li><li>- të përcaktojë gjendjen mendore dhe shpirtërore të individit në nevojë;</li><li>- të kontrollojë mjediset sanitare të individit në nevojë;</li><li>- të zbulojë i ritualet zakonore të individit në nevojë;</li><li>- të zbulojë traditën familjare në kontekstin e përkujdesjes trupore për individin në nevojë;</li><li>- të bëjë evidentimin e gjendjes financiare të individit në nevojë;</li></ul>	

- 
- të informojë individin në nevojë për rëndësinë e përkujdesjes trupore;
  - të respektojë përkatësinë gjinore, moshën dhe statusin social të individit në nevojë.

## **RM 2 Nxënësi vrojton lëkurën e individit në nevojë.**

### ***Përmbajtja***

- Përzgjedhja e mjeteve të punës.
- Vlerësimi i ngjyrës, ngrohtësisë së lëkurës si dhe trupave të huaj.
- Vlerësimi i funksionimit të djersitjes së lëkurës.
- Përcaktimi i parametrave të lëkurës
- Vrojtimi i gjendjes dhe ndryshimeve të enëve të gjakut të lëkurës.

### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë mjeteve të punës;
- të vlerësojë ngjyrën, ngrohtësinë e lëkurës si dhe trupat e huaj;
- të vlerësojë funksionimin e djersitjes së lëkurës;
- të përcaktojë prametrat e lëkurës si elasticiteti, furnizimi me gjak, thatësia dhe defektet;
- të vrojtojë gjendjen dhe ndryshimet e enëve të gjakut të lëkurës.

## **RM 3 Nxënësi përkujdeset për lëkurën e thatë të individit në nevojë**

### ***Përmbajtja***

- Përzgjedhja e mjeteve të punës.
- Trajtimi i lëkurës së thatë nga brenda.
- Kryerja e banjës jo të gjatë.
- Trajtimi i lëkurës së fytyrës.
- Trajtimi i lëkurës së duarve.
- Trajtimi i lëkurës së trupit.
- Lyerja me krem e zonave të rrezikuara për dekubitues.
- Përdorimi i kremrave, solucionëve, vajrave dhe pomadave për lëkurën e fytyrës.

### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë drejt mjetet e punës, solucionet dhe kremrat;
- të trajtojë tharjen e lëkurës nga brenda, duke shtuar sasinë e lëngjeve të duhura;
- t'i kryejë banjo jo të gjatë individit në nevojë;
- të kryejë trajtimin e lëkurës së fytyrës;
- të kryejë trajtimin e lëkurës së duarve;
